

REZOLUTË

PËR RAPORTIN E KËSHILLIT DREJTUES PËR VEPRIMTARINË VJETORE TË RTSH-SË PËR VITIN 2005

Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, pasi u njoh me Raportin e Këshillit Drejtues të RTSH-së për vitin 2005, vëren se:

Në rezolutën që Kuvendi i Republikës së Shqipërisë ka miratuar për veprimtarinë e RTSH-së një vit më parë, është synuar që RTSH-ja të marrë atributet e një institucioni publik të rëndësishëm mediatik, duke u shndërruar realisht në një institucion që i nënshtrohet vetëm detyrimit të ligjit dhe jo trysnive politike.

Në raportin e paraqitur nga Këshilli Drejtues i RTSH-së pranohen disa arritje, si në drejtim të strukturës së programeve, ashtu edhe për sa i përket administrimit të buxhetit, për të cilin pretendohet se është i pamjaftueshëm për mirëfunksionimin e këtij institucioni dhe e dobëson atë në konkurrencën me operatorët privatë.

Nga raporti evidentohet, gjithashtu, se ende nuk është arritur që RTSH-ja të jetë një operator publik dhe në shërbim të publikut. RTSH-ja nuk shkapet kollaj nga kontrolli politik.

Sikurse rezulton nga Raporti i Këshillit Drejtues, RTSH-ja ka nevojë për reformë të thellë si në drejtim të strukturave programore, ashtu edhe në përmirësimin e funksionimit të tij në shërbim të publikut. Prania e publikut është e vakët, ndërsa drejtuesit ekzekutivë shpeshherë shpërfillin vendimet e Këshillit, duke krijuar kosto për mbarëvajtjen e këtij institucioni të rëndësishëm për informimin dhe edukimin e publikut të gjerë.

Raporti i Këshillit Drejtues të RTSH-së pretendon se gjatë periudhës 2005-2006 Këshilli Drejtues është përpjekur të zbatojë ligjin dhe detyrimet që rrjedhin prej tij, si dhe ka evidentuar disa nga problemet kryesore që lidhen me marrëdhëniet Këshill Drejtues-Drejtori e Përgjithshme. Raporti nxjerr në pah se me gjithë përpjekjet e Këshillit, marrëdhëniet e tij me strukturat ekzekutive të RTSH-së kanë qenë shpeshherë të tensionuara dhe me probleme.

Kuvendi i Republikës së Shqipërisë vlerëson se këto pretendime nuk qëndrojnë.

Raporti i paraqitur nga Këshilli Drejtues i RTSH-së nuk u referohet vërejtjeve dhe problemeve që ka evidentuar Kontrolli i Lartë i Shtetit, pas verifikimit të shpenzimeve të fondeve publike, por paraqet thjesht një pasqyrë, sipas së cilës parashikimet në buxhet dhe në buxhetin faktik janë realizuar pothuajse 100 për qind. Këtu duhet përmendur fakti se RTSH-ja nuk ka mundur të arkëtojë borxhin prej 127 856 480 lekësh që konkurrentët privatë i kanë këtij institucioni. Probleme ka pasur edhe për sa i përket çështjeve të pagave dhe shpërblimeve, kryesisht për disa nga anëtarët e stafit të Drejtorit të Përgjithshëm.

Ende nuk është realizuar detyra e lënë për reformimin e strukturës së pagave dhe përpilimin e piramidës së pagave të miratuara nga Këshilli Drejtues.

Në gjykojmë se më e rëndësishme në punën e Këshillit Drejtues, siç tregon edhe raporti i vitit të kaluar për veprimtarinë e RTSH-së, nuk është numri i mbledhjeve të realizuara, por realizimi i detyrave ligjore dhe përllogaritja e arritjeve të realizuara në krahasim me veprimtarinë e vitit të kaluar. Në këtë këndvështrim, Kuvendi mendon se Këshilli Drejtues nuk ka zbatuar detyrimet ligjore dhe nuk i ka realizuar objektivat e tij.

Kuvendi, që vitin e kaluar, në Rezolutën e miratuar për veprimtarinë e RTSH-së vlerëson se “Këshilli Drejtues i RTSH-së nuk ka përmbushur detyrimet që i ngarkon ligji dhe për të cilat është votuar nga ky Kuvend”. Pas një viti vërejmë se nuk ka ndodhur asgjë. Mbi këtë bazë kërkohet shkarkimi i këtij Këshilli Drejtues dhe ngritja e Këshillit të ri mbi bazën e ligjit të ri të miratuar.

Tiranë, më 15.5.2006